



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.175/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në objekte të ndryshme publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,250.00 (tremij e dyqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 09 Qershor 2017 ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 08.06.2017, në rrugën “Ibrahim Lutfiu” në afërsi të shkollës së mesme “Sami Frashëri” në Prishtinë, monitoruesit e tyre kanë hasur në poster të kandidatës për deputete nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, të ngjitura në Sahat Kullën e Prishtinës, në vend - pritjen e stacionit të autobusëve dhe në shtyllat publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur tri fotografi të printuara të ldhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë i datës 10.06.2017, koalicioni PDK-AAK-NISMA, thekson se shkelja zgjedhore nuk është e qëllimshme dhe se këto shkelje janë bërë nga aktivistë të painformuar mirë lidhur me rregullat zgjedhore pra respektivisht Rregullën Zgjedhore NR.11/2013. Prandaj koalicioni PDK-AAK-NISMA ka ndërmarrë masat e duhura për përmirësimin e shkeljes së pretenduar sipas ankesës. Si dëshmi ka bashkangjitur tri fotografi nga ku janë larguar posterat e kandidatës në fjalë, nga aty ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatës për deputete nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA janë vendosur në vende të ndryshme pra të gjitha në objekte dhe vende publike, pra veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) i LZP-së e cila përcakton *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve, në apo mbi rrugë publike si dhe brenda ose jasht ndërtesave publike ose godinave”*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA , është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri i kandidatës për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA , është i vendosur në shenjat publike të trafikut.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, prandaj shkeljen zgjedhore vazhdimisht e kanë përsëritur si dhe faktin se posterat e kandidatës për deputete nga ky koalicion janë vendosur në objekte dhe vende të ndryshme publike. Paneli e urdhëroi koalicionin PDK-AAK-NISMA, për ta përmirësuar shkeljen e bërë të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, brenda afatit të caktuar, ku i njëjti ka ndërmarr veprime e duhura për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë posterat nga vendet ku ka ndodhur shkelja, të cilat veprime kanë ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.175/2017 më datën 10.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Rafet Haxhaj", written over a horizontal line.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së*